



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1265/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Mirlinda Gashi kandidat për anëtarë të Asamble Komunale nga rradhët e Subjektit Politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK), Malishevë, paraqitur kundër Qendrës së Numrimit të Rezultateve (QNR), për shkak të publikimit të rezultateve perfundimtare për Asamble Komunale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e pas afatshme ankesa e Mirlinda Gashi kandidat për anëtarë të Asamble Komunale nga rradhët e Subjektit Politik PDK, Malishevë .

Arsyetim

PZAP-i, më datë 04.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Mirlinda Gashi kandidat për anëtarë të Asamble Komunale nga rradhët e Subjektit Politik PDK, Malishevë, e cila pretendon që të verifikohet procesi i numërimit në këtë Qendër të Votimit, sipas rezultateve të publikuara më datë 03.11.2013 nga Qendra në fshatë i kam pasur 47 vota, ndërsa në rezultatet e shpallura nga KQZ-së në këtë Qendër rezultojnë se posedon 30 vota, si dëshmitar ka propozuar si dëshmitar Qendrim Gashi, Dalip Gashi, Elmi Gashi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pa afatshme

PZAP-i , konstatoi se anëkesa është e pa afatshme ngase, afati për të parashtruar anëkes ndaj vendimeve të KQZ-së, është 24 orë nga moment i publikimit të vendimit, që nenkupton se ky afatë ka qenë deri më datë 03.12.2013 në ora 16:30 ndërsa anëkesa është parashtruarë, në PZAP nga pala ankuese me datë 04. 12 2013 në ora 09:36, nga kjo del se ankesa është e pa afatshme, pprandaj në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, u vendos si në dispozitivë të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 1265/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.